

Gjyqtare Mimoza Tasi

Znj. Tasi, e lindur në Tiranë në vitin 1967, ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike, dega “Filozofi” në vitin 1990 dhe është diplomuar “juriste” në vitin 2000, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2008 ka kryer studimet pasuniversitare “Master për Studime Europiane” në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2012 ka kryer kursin teorik të studimeve për Doktoraturë në Fushën e Sigurisë pranë Akademisë së Forcave të Armatosura.

Nga viti 1993 deri në vitin 2020 znj. Tasi ka punuar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ka ushtruar detyra të ndryshme në nivel ekzekutiv dhe drejtues, duke u promovuar me ngritje në detyrë si sekretare komisioni parlamentar (1993), këshilltare ligjore pranë Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut (2002), këshilltare në shërbimin e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura (2014) dhe drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare (2015). Për shkak të pozicionit ka qenë e përfshirë në reformën kushtetuese (1998, 2008, 2012), rishikimin e legjislacionit të pushtetit gjyqësor (2007), reformën parlamentare (2013), si dhe grupe pune për hartim legjislacioni. Gjatë viteve të zhvillimit të karrierës së saj, znj. Tasi ka vijuar të ndjekë edhe kurse, trainime e seminare brenda e jashtë vendit për rritjen e kapaciteteve profesionale, duke fituar tituj e certifikata të ndryshme, si titullin “avokat” (2003) - Dhoma e Avokatisë Tiranë, “trajner” pranë Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (2004) – dhe prezantuar modulin për organizimin dhe funksionet e Kuvendit, deri në vitin 2007.

Dy vitet e fundit (janar 2020 – janar 2022) ka punuar si oficere ligjore pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, duke kontribuuar në projektin 4 vjeçar “Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin qytetar në Shqipëri”, financuar nga Konfederata Zviceriane.

Me vendimin nr. 82/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, znj. Tasi u zgjodh anëtarë zëvendësuese e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nga data 1 shkurt 2022 ka marrë detyrën e gjyqtares pranë këtij Kolegji.